



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1750 Prot

Tiranë, më 13.12.2019

V E N D I M

Nr. 184, datë 13.12.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Gramsh të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Gramsh,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me Urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Gramsh.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Këshilli i Bashkisë Gramsh, me Vendimin nr. 94, datë 27.12.2018, “Për miratimin e numrit maksimal dhe nivelit të pagave e të shpërblimeve të punonjësve e

personave të tjerë, të zgjedhur dhe të emëruar, të Bashkisë Gramsh, për vitin 2019”, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Gramsh dhe njësisive administrative e institucioneve në varësi të saj. Në zbatim të këtij vendimi, bazuar në nenin 64, shkronja “j”, të ligjit nr. 139/2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”, Kryetari i Bashkisë Gramsh ka nxjerrë Vendimin nr. 04, datë 10.01.2019, “*Për miratimin e strukturës organizative për Bashkinë Gramsh dhe njësisive në varësi të saj, për vitin 2019*”, i ndryshuar. Kjo strukturë dhe organikë është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Gramsh së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **44** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **1** pozicioni i kategorisë së lartë drejtuese, **4** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese; **11** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **28** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se **30** pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **12** pozicione të shërbimit civil, rezulton se, aktualisht janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues; ndërsa **2** pozicione të shërbimit civil rezultuan vende vakante.

Konkretisht, në rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, përfshihen **12** punonjës, të cilët janë evidentuar si më poshtë, sipas aktit të emërimit të nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. ***** , me detyrë “*Përgjegjës i Burimeve Njerëzore*”, akt emërimi Urdhër nr. 180, datë 15.08.2019, “*Për emërim të përkohshëm punonjësi në sektorin e Burimeve Njerëzore*”, i Kryetarit të Bashkisë.
2. ***** , me detyrë “*Specialist për Ndhimën Ekonomike*”, akt emërimi Urdhër nr. 176, datë 15.08.2019, “*Për emërim të përkohshëm punonjësi në njësinë administrative Kushovë*”, i Kryetarit të Bashkisë.
3. ***** , me detyrë “*Specialist i Rinisë*”, akt emërimi Urdhër nr. 204, datë 09.09.2019, “*Për emërim të përkohshëm punonjësi në sektorin e njësinë për Koordinimin e Integritimit Evropian dhe Ndhimës së Huaj*”, i Kryetarit të Bashkisë.
4. ***** , punonjës në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit Juridik*”, liruar nga kjo detyrë dhe emëruar përkohësisht në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë Juridike*”, akt emërimi Vendim nr. 68, datë 20.06.2019, “*Për transferim të përkohshëm të nëpunësit civil ***** në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë Juridike”*”, i Kryetarit të Bashkisë.
5. ***** , punonjës në Sektorin e Ujitjes dhe Kullimit, transferuar në pozicionin “*Kryeinspektor i IMT*”, akt emërimi Urdhër nr. 209, datë 12.09.2019, “*Për*

transferim punonjësi në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit”, i Kryetarit të Bashkisë.

6. *****, me detyrë *“Inspektor Tatim-Taksa për Bizneset”*, akt emërimi Urdhër nr. 139, datë 19.06.2019, *“Për emërim të përkohshëm punonjësi në sektorin e Tatim Taksave”*, i Kryetarit të Bashkisë.
7. *****, me detyrë *“Specialist për Bujqësinë”*, akt emërimi Urdhër nr.59, datë 15.03.2019, *“Për emërim të përkohshëm Specialist në Sektorin e Shërbimeve Veterinari, Mbrojtje e Tokës, Bujqësi”*, i Kryetarit të Bashkisë.
8. *****, me detyrë *“Specialist për Emergjencat Civile”*, akt emërimi Urdhër nr. 120, datë 27.05.2019, *“Për emërim të përkohshëm Specialist në Sektorin e Emergjencave Civile”*, i Kryetarit të Bashkisë.
9. *****, me detyrë *“Specialist për Koordinimin e Marrëdhënieve me NJA”*, akt emërimi Urdhër nr. 118, datë 27.05.2019, *“Për emërim të përkohshëm Specialist në Sektorin Juridik”*, i Kryetarit të Bashkisë.
10. *****, me detyrë *“Specialist, Mirëmbajtës i Rrjetit Kompjuterik (IT)”* në Drejtorinë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, akt emërimi Vendim nr. 05, datë 29.01.2015, *“Për emërim punonjësi administrativ në aparatin e bashkisë”*, i Kryetarit të Bashkisë.
11. *****, me detyrë *“Specialist për Emergjencat Civile, Topograf”*, në Sektorin e Politikave të Shërbimeve Publike, akt emërimi Urdhër nr. 05, datë 12.01.2017, *“Për emërim punonjësi të përkohshëm në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Sektori i Politikave të Shërbimeve Publike”*, i Kryetarit të Bashkisë.
12. *****, me detyrë *“Përgjegjës për Ndihmën Sociale”*, në Drejtorinë Ekonomike e Buxhetit, akt emërimi Vendim nr. 35, datë 21.03.2016, *“Për emërim punonjësi në shërbimin civil”*, i Kryetarit të Bashkisë.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, si në rastin e administratës së bashkisë, ashtu edhe të njësive administrative, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. *Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.*

Vërej se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Gramsh, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Gjithashtu, nga struktura organizative e Bashkisë evidentohet se, pozicionet e punës pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit pjesë e strukturës, janë trajtuar si pozicione pune pjesë e shërbimit civil, ndërkohë që me miratimin e ligjit nr. 183, datë 24.12.2014, ka ndryshuar statusi i punësimit për punonjësit e Inspektoratit në nivel qendror dhe vendor, duke i konsideruar këto pozicione jashtë shërbimit civil.

Konkretisht, referuar ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, i ndryshuar, përcaktohet se kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, i njësisë vendore dhe Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, në nivel qendror.

Në kuptim të nenit 4, të ligjit të sipërcituar, pranë njësive të qeverisjes vendore, ngrihet Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, e cila është njësi organizative që përbëhet nga

Kryeinspektori dhe inspektorët, si dhe është kompetente për ushtrimin e përgjegjësive të kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike si dhe kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në përputhje me përcaktimet ligjore, brenda territorit administrativ të njësisë vendore.

Vlen të theksohet se, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe në referencë të Lidhjes nr. 1, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, Inspektoriati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar (sot *Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit*) ka qenë pjesë e shërbimit civil.

Më tej, me miratimin e ligjit nr. 183, datë 24.12.2014, “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme*”, sipas përcaktimeve të nenit 17, pika 1, të këtij ligji, rezulton se, institucioni i Inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar (INUK), është riorganizuar në institucionin e emërtuar Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT). Nga përmbajtja e dispozitave të këtij ligji rezulton se, kompetencat dhe natyra e këtij institucioni kanë pësuar ndryshime, të cilat janë shoqëruar dhe me ndryshimin e marrëdhënies së punës dhe të mënyrës së administrimit të burimeve njerëzore të këtij institucioni.

Konkretisht, në zbatim të nenit 8, pika 4, të ligjit në fjalë, punonjësit e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, gëzojnë të drejtën e pajisjes me armë dhe të përdorimit të tyre sipas legjislacionit përkatës, ç’ka në referencë të nenit 2, gërma h), të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i përjashton ata nga fusha e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

Për këtë arsye, si dhe në kuptim të Kreut IV, “*Dispozitat e fundit*”, pika 3, të Vendimit nr. 893, datë 04.11.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit*”, marrëdhënia e punësimit për këta punonjës rregullohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 7961, datë 12.07.2005, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Në të njëjtën linjë, vjen ligji specifik edhe në lidhje me punonjësit e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, pranë njësisë të qeverisjes vendore, ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme*”, i ndryshuar, kur, ndër të tjera, në nenin 4 të tij, përcakton shprehimisht se, kjo njësi organizative drejtohet nga Kryeinspektori, i cili emërohet nga Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore. Në këto kushte marrëdhënia e punësimit për këta punonjës nuk rregullohet nga skema e shërbimit civil, por sipas përcaktimeve të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje sa më sipër, si dhe në referencë të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, vlerësohet se, punonjësit e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në njësitë e qeverisjes vendore në përgjithsi, dhe në rastin konkret në Bashkinë Gramsh, nuk përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, si rrjedhim gjatë hartimit të strukturës së re së Bashkisë, duhet të merren masa për trajtimin e këtyre pozicioneve të punës si pozicione jashtë shërbimit civil.

Sa i takon aplikimit të institutit të disiplinës, për rastet e shkeljeve disiplinore të kryera nga punonjësit, rezultoi se, në Bashkinë Gramsh, ka nisur një procedurë ecurie disiplinore, për nëpunësin *****, sipas objektit të përcaktuar në Relacionin nr. 5634 prot, datë 10.09.2019, *“Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit civil ***** me detyrë “Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar”*”, të Kryetarit të Bashkisë.

Në përfundim të procedurës për dhënien e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor me Vendimin nr. 108, datë 24.09.2019, *“Për masën disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë prej 2 (dy) vitesh”, të marrë ndaj nëpunësit civil, *****”*, ka vendosur që për shkeljet e rënda të kryera nga punonjësi ***** të merret masa disiplinore *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për periudhë për dy vjet”*.

Nëpërmjet kërkesës personale me nr. 5853 prot., datë 19.09.2019, punonjësi ***** me detyrë *“Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar”*, ka kërkuar të largohet nga kjo detyrë dhe të kaloj në një pozicion më të ulët *“Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave dhe Buxhetit”*, në Bashkinë Gramsh. Kjo kërkesë është pranuar dhe me Vendimin nr. 120, datë 16.10.2019, të njësisë përgjegjëse, punonjësi ***** është emëruar në pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit dhe të Ardhurave”*, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, në Bashkinë Gramsh.

Nga përmbajtja e relacionit nr. 5634 prot., datë 10.09.2019, të Kryetarit të Bashkisë Gramsh, rezulton se, me vendimin penal nr. 359, datë 21.05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shtetasi ***** është deklaruar fajtor për veprën penale *“Ndërtim i paligjshëm”*, duke u dënuar me 4 muaj burgim, dënim i cili është konvertuar në punë në interes publik pa shpërblim, në favor të Bashkisë Gramsh, për një kohë prej 80 orë punë, dënim të cilin e ka kryer, sipas informacionit të marrë nga njësia përgjegjëse pranë kësaj bashkie.

Në lidhje me këtë rast, në interpretim të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, sqarojmë sa më poshtë vijon:

Në kuptim të ligjit të sipërcituar, “nëpunës civilë” janë “nëpunësit e institucioneve të administratës publike të nivelit qendror apo vendor, të cilët ushtrojnë autoritetin publik, në detyra të natyrës drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse apo ekzekutuese ...”.

Në kriteret që ky i fundit ka përcaktuar për t’u bërë pjesë e sistemit të shërbimit civil, e konkretisht, në nenin 21 të tij, “Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil”, në germën d), parashikohet në mënyrë taksative sa më poshtë:

“Për pranimin në shërbimin civil, një kandidat duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme si më poshtë:

...

d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

...”

Kjo dispozitë nuk lë hapësira për interpretim. Ajo është mbartëse e frymës dhe qëllimit për të cilin u hartua dhe miratua ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i cili, në nenin 1 të tij, parashikon se:

“Ky ligj ka për qëllim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.”

Në mënyrë të posaçme, pastërtia e figurës së nëpunësve që kryejnë funksione publike sanksionohet edhe në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në nenin 1 të të cilit parashikohet se:

“1. Qëllimi i këtij ligji është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas këtij ligji.

2. Objekti i këtij ligji është mbrojtja dhe garantimi i mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit, organeve të qeverisjes vendore, institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj, administratës publike, Forcave të Armatosura, organeve të rendit publik, sigurisë kombëtare dhe çdo institucioni apo entiteti tjetër ekonomik shtetëror, nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikëbërje dhe/ose vendimmarrje i personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, sipas këtij ligji.”

Në nenin 3, “Ndalimi për t’u emëruar në një funksion publik”, në pikën 1 të këtij ligji, përcaktohet se, për veprat penale të parashikuara në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji, personi nuk mund të emërohet apo zgjidhet në funksionet publike si më poshtë:

“...
e) në shërbimin civil ...
...”

Më tej, në nenin 14 “Pezullimi dhe përfundimi i ushtrimit të funksionit publik për funksionarët në detyrë”, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, parashikohet shprehimisht se:

“1. Ndalimet e këtij ligji zbatohen ndaj të gjitha kategorive të zyrtarëve, të cilët, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbajnë një mandat apo detyrë publike sipas përcaktimeve të këtij ligji nëse faktet apo rrethanat që përbëjnë kusht për zbatimin e këtij ligji kanë ndodhur përpara marrjes së funksionit publik. Konstatimi i kushteve të përcaktuara si ndalim nga ky ligj passjell përfundimin e ushtrimit të funksionit publik.”

Ndërkohë, pika 3 e nenit 15 “Trajtimi i funksionarëve publikë aktualë”, të këtij ligji, sanksionon sa më poshtë:

“3. Nëse provohet se ekzistojnë rrethanat për ndalimin e zgjedhjes apo emërimit, zbatohen procedurat e nevojshme kushtetuese apo ligjore për mbarimin e mandatit apo shkarkimin nga detyra.”

Sa më sipër dëshmon edhe një herë, frymën e legjislacionit për të mos lejuar në asnjë rast pjesëmarrjen apo punësimin në administratën publike të personave që janë dënuar me vendime gjyqësore të formës së prerë, për një vepër penale, e cila cënon integritetin moral të nëpunësit civil dhe besimin e publikut në institucionet e administratës publike.

Bazuar në analizën e mësipërme, konkludojmë se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Gramsh, duhet të marrë masat për përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil në rastin e punonjësit ***** emëruar me vendimin nr. 120, datë 16.10.2019, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit dhe të Ardhurave”, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, në Bashkinë Gramsh.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, si dhe referuar nenit 65, germa d), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, seksioni III, “Procedura hetimore”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **12** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, të cilët janë evidentuar si më poshtë:
 1. *****, me detyrë “Përgjegjës i Burimeve Njerëzore”, akt emërimi Urdhër nr. 180, datë 15.08.2019, “Për emërim të përkohshëm punonjësi në sektorin e Burimeve Njerëzore”, i Kryetarit të Bashkisë.
 2. *****, me detyrë “Specialist për Ndihmën Ekonomike”, akt emërimi Urdhër nr. 176, datë 15.08.2019, “Për emërim të përkohshëm punonjësi në njësinë administrative Kushovë”, i Kryetarit të Bashkisë.
 3. *****, me detyrë “Specialist i Rinisë”, akt emërimi Urdhër nr. 204, datë 09.09.2019, “Për emërim të përkohshëm punonjësi në sektorin e njësinë për Koordinimin e Integritit Evropian dhe Ndihmës së Huaj”, i Kryetarit të Bashkisë.
 4. *****, punonjës në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit Juridik”, liruar nga kjo detyrë dhe emëruar përkohësisht në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë Juridike”, akt emërimi Vendim nr. 68, datë 20.06.2019, “Për transferim të përkohshëm të nëpunësit civil ***** në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë Juridike””, i Kryetarit të Bashkisë.
 5. *****, punonjës në Sektorin e Ujitjes dhe Kullimit, transferuar në pozicionin “Kryeinspektor i IMT”, akt emërimi Urdhër nr. 209, datë 12.09.2019, “Për transferim punonjësi në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit”, i Kryetarit të Bashkisë.
 6. *****, me detyrë “Inspektor Tatim-Taksa për Bizneset”, akt emërimi Urdhër nr. 139, datë 19.06.2019, “Për emërim të përkohshëm punonjësi në sektorin e Tatim Taksave”, i Kryetarit të Bashkisë.
 7. *****, me detyrë “Specialist për Bujqësinë”, akt emërimi Urdhër nr.59, datë 15.03.2019, “Për emërim të përkohshëm Specialist në Sektorin e Shërbimeve Veterinari, Mbrojtje e Tokës, Bujqësi”, i Kryetarit të Bashkisë.
 8. *****, me detyrë “Specialist për Emergjencat Civile”, akt emërimi Urdhër nr. 120, datë 27.05.2019, “Për emërim të përkohshëm Specialist në Sektorin e Emergjencave Civile”, i Kryetarit të Bashkisë.
 9. *****, me detyrë “Specialist për Koordinimin e Marrëdhënieve me NJA”, akt emërimi Urdhër nr. 118, datë 27.05.2019, “Për emërim të përkohshëm Specialist në Sektorin Juridik”, i Kryetarit të Bashkisë.
 10. *****, me detyrë “Specialist, Mirëmbajtës i Rrjetit Kompjuterik (IT)” në Drejtorinë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, akt emërimi Vendim nr. 05,

datë 29.01.2015, “Për emërim punonjësi administrativ në aparatit e bashkisë”, i Kryetarit të Bashkisë.

11. ***** , me detyrë “*Specialist për Emergjencat Civile, Topograf*”, në Sektorin e Politikave të Shërbimeve Publike, akt emërimi Urdhër nr. 05, datë 12.01.2017, “Për emërim punonjësi të përkohshëm në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Sektori i Politikave të Shërbimeve Publike”, i Kryetarit të Bashkisë.
12. ***** , me detyrë “*Përgjegjës për Ndhmën Sociale*”, në Drejtorinë Ekonomike e Buxhetit, akt emërimi Vendim nr. 35, datë 21.03.2016, “Për emërim punonjësi në shërbimin civil”, i Kryetarit të Bashkisë,

si dhe të rregullohen pasojat duke i shpallur të lira këto pozicione, me qëllim që të plotësohen në përputhje me ligjin, nëpërmjet konkurrimit.

2. Njësia përgjegjëse, të marrë masat për përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil për punonjësin ***** , emëruar me vendimin nr. 120, datë 16.10.2019, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit dhe të Ardhurave*”, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, në Bashkinë Gramsh.
3. Njësia përgjegjëse të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për ato pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në të cilat mungojnë, dhe të vijojë procesi i plotësimit të pozicioneve të lira, në zbatim të kërkesave të ligjit dhe në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të paralajmërimit.
4. Pozicionet e punës pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Gramsh, me hartimin dhe miratimin e strukturës së re të Bashkisë, të trajtohen si pozicione pune jashtë shërbimit civil, në respektim të kërkesave ligjore.
5. Të përmbyllet procesi i mbikëqyrjes i cili është finalizuar me vendimin paralajmërues nr. 77, datë 03.08.2018, të Komisionerit, për institucionin e Bashkisë Gramsh dhe të vijojë rregullimi i ligjshmërisë sipas urdhërimeve të dispozitivit të këtij vendimi.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Gramsh, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur

mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Gramsh, Ministria e Brendshme dhe Prefekti i Qarkut Elbasan. Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Gramsh duhet të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim për detyrat e lëna në dispozitivin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha